

Fondi BESA Sh.a.
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011
(me raportin e auditorëve të pavarur bashkangjitur)

Përmbajtja

Raporti i Auditorëve të Pavarur	i-ii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	2
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor	3
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit	4
1 Njësia raportuese	5
2 Bazat e përgatitjes	7
3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël	8
4 Administrimi i riskut financiar	12
5 Përdorimi i vlerësimit dhe gjykimit	19
6 Përcaktimi i vlerës së drejtë	19
7 Mjete monetare dhe ekuivalente me to	21
8 Depozita me afat me bankat	21
9 Huatë dhënë klientëve	21
10 Aktive të qëndrueshme të turpëzuara	22
11 Investime në aktive të qëndrueshme	23
12 Tatimi i shtyrë aktiv	23
13 Aktive të tjera	23
14 Hua dhe kredi	24
15 Borxh i varur	25
16 Grantet	26
17 Detyrime të tjera	27
18 Kapitali aksioner	28
19 Rezerva ligjore	28
20 Të ardhura nga interesat	28
21 Shpenzime për interesa	28
22 Të ardhura të tjera, neto	29
23 Shpenzime personeli	29
24 Shpenzime të tjera administrative	29
25 Tatimi mbi fitimin	30
26 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	30
27 Transaksionet me palët e lidhura	30
28 Ngjarjet pas datës së raportimit	31



KPMG Albania Sh.p.k
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të
Fondi Besa Sh.A

Tiranë, 27 mars 2012

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Fondi Besa Sh.A ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2011, pasqyrat e të ardhurave përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2011, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Fondi BESA Sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar

(shumat në Lek)

	Shënime	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	7	153,272,707	554,792,021
Depozita me afat me bankat	8	921,913,292	679,038,498
Hua dhënë klientëve	9	4,330,286,977	4,270,379,333
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	10	75,508,113	80,997,814
Investime në aktive të qëndrueshme	11	21,644,171	18,357,844
Tatimi i shtyrë aktiv	12	-	527,578
Tatim fitimi i parapaguar		8,563,327	-
Aktive të tjera	13	1,633,826	1,066,402
Totali i aktiveve		5,512,822,413	5,605,159,490
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet			
Hua dhe kredi	14	2,585,101,254	2,795,402,867
Borxh i varur	15	1,802,561,220	1,821,285,566
Grante	16	44,776,714	28,023,588
Tatim fitimi i pagueshëm		-	27,264,212
Detyrime të tjera	17	98,253,637	82,554,692
		4,530,692,825	4,754,530,925
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	833,092,000	605,261,000
Rezerva ligjore	19	17,536,565	5,540,725
Fitime të mbartura		131,501,023	239,826,840
		982,129,588	850,628,565
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		5,512,822,413	5,605,159,490

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese dhe pjesë përbërëse e pasqyrave financiare nga faqja 5 deri në faqen 31.

Fondi BESA Sh.a.

Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

(shumat në Lek)

	Shënime	2011	2010
Interesa			
Të ardhura nga interesat	20	1,151,620,753	1,115,222,429
Shpenzime për interesa	21	(272,179,816)	(289,179,330)
Të ardhura neto nga interesat		879,440,937	826,043,099
Të ardhura të tjera			
Të ardhura nga grantet	16	10,720,798	6,387,396
Të ardhura të tjera, neto	22	79,491,232	64,279,157
Totali të ardhurave të tjera		90,212,030	70,666,553
Shpenzime operative			
Humbja nga zhvlerësimi i kredive për klientët	9	(194,421,338)	(89,374,881)
Shpenzime personeli	23	(385,161,320)	(341,709,146)
Shpenzime të tjera administrative	24	(210,548,213)	(168,043,557)
Amortizimi	10,11	(31,125,262)	(25,131,151)
Humbja neto nga lëvizjet në kursin e këmbimit		(1,694,963)	(5,338,008)
Totali shpenzimeve operative		(822,951,096)	(629,596,743)
Fitimi para tatimit		146,701,871	267,112,909
Shpenzimi për tatimin mbi fitim	25	(15,200,848)	(27,286,069)
Fitimi neto i periudhës		131,501,023	239,826,840
Të ardhura të tjera përmbledhëse neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali të ardhurave përmbledhëse për vitin që i atribuohet aksionerëve të Shoqërisë		131,501,023	239,826,840

Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese dhe pjesë përbërëse të pasqyrave financiare nga faqja 5 deri në faqen 31.

Fondi BESA Sh.a.

Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor

(shumat në Lek)

	Shënime	2011	2010
Flukset e arkës nga aktivitete operative			
Fitimi neto i periudhës		131,501,023	239,826,840
<i>Korrigjime për rakordimin e ndryshimeve të aktiveve neto me mjetet monetare neto nga aktivitetet operative:</i>			
Amortizimi	10,11	31,125,262	25,131,151
Fitime nga pakësimet e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(1,614,793)	(255,913)
Humbjet nga zhvlerësimi i huave për klientët	9	194,421,338	89,374,881
Hua të fshira	22	2,595,401	2,993,074
Amortizimi i granteve	16	(10,720,798)	(6,387,396)
Diferenca të kursit të këmbimit nga rivlerësimi i granteve	16	(149,302)	78,389
Të ardhura nga interesat		(1,151,620,753)	(1,115,222,429)
Shpenzime për interesa		272,179,816	289,179,330
Shpenzimi për tatimin mbi fitim		15,200,848	27,286,069
Amortizimi i komisioneve të garancisë	9	(79,501,484)	(81,535,832)
<i>Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:</i>			
Rritje në hua për klientët		(264,739,720)	(320,553,317)
Rritje/(ulje) në aktive të tjera		(39,846)	1,628,838
Rritje në detyrime të tjera		15,698,945	16,787,575
Interesi i arkëtuar		1,132,033,838	1,069,110,842
Interesi i paguar		(287,063,928)	(267,553,799)
Tatimi mbi fitimi i paguar		(51,028,387)	(14,024,393)
Komisione garancive të arkëtuara	9	83,409,152	77,942,010
Flukse e arkës të gjeneruara nga aktivitetet operative		31,686,612	33,805,920
Flukset e arkës nga aktivitete investuese			
Rritje në depozitat me afat në banka		(219,380,210)	(621,743,484)
Përvetësimi i aktiveve të qëndrueshme	11	(8,332,800)	(7,023,552)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	10	(24,877,997)	(30,573,270)
Arkëtime nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		5,903,702	916,303
Flukset e arkës përdorur në aktivitete investuese		(246,687,305)	(658,424,003)
Flukset e arkës nga aktivitete financuese			
(Ulje)/rritje në fondet e marra hua dhe borxhin e varur		(214,141,847)	1,097,724,388
Të ardhurat nga grantet		27,623,226	20,004,095
Flukset e arkës (përdorur në)/gjeneruar nga aktivitetet financuese		(186,518,621)	1,117,728,483
(Ulje)/rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to		(401,519,314)	493,110,400
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	7	554,792,021	61,681,621
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	7	153,272,707	554,792,021

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese dhe pjesë përbërëse e pasqyrave financiare nga faqja 5 deri në faqen 31.

Fondi BESA Sh.a.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit

(shumat në Lek)

	Kapitali i paguar	Fitime të mbartura	Rezerva ligjore	Totali
Gjendja më 1 Janar 2010	500,000,000	110,801,725	-	610,801,725
Totali të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Fitimi neto i vitit	-	239,826,840	-	239,826,840
Të ardhura të tjera përmbledhëse neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali	-	239,826,840	-	239,826,840
Transaksionet e aksionerëve, të njohura direkt në kapital				
Rritje e kapitalit aksioner	105,261,000	(105,261,000)	-	-
Rezerva ligjore	-	(5,540,725)	5,540,725	-
Totali	105,261,000	(110,801,725)	5,540,725	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	605,261,000	239,826,840	5,540,725	850,628,565
Totali të ardhurave përmbledhëse për vitin				
Fitimi neto i vitit	-	131,501,023	-	131,501,023
Të ardhura të tjera përmbledhëse neto nga tatimi mbi fitimin	-	-	-	-
Totali	-	131,501,023	-	131,501,023
Transaksionet e aksionerëve, të njohura direkt në kapital				
Rritje e kapitalit aksioner	227,831,000	(227,831,000)	-	-
Rezerva ligjore	-	(11,995,840)	11,995,840	-
Totali	227,831,000	(239,826,840)	11,995,840	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	833,092,000	131,501,023	17,536,565	982,129,588

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit duhet të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese dhe pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 31.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga drejtimi i Fondit BESA Sh.a. më datë 27 Mars 2012 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Bajram Muça
Drejtor Ekzekutiv



Irma Disha
Drejtoreshë Financiare

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përvec kur nuk është shprehur ndryshe)

1 Njësia raportuese

Fondi BESA Sh.a. (“Shoqëria”) është një shoqëri anonime me qendër në Tiranë, e cila operon në fushën e mikro-financës për individë dhe bizneset e vogla dhe të mesme. Shoqëria është themeluar më 10 Korrik 2008 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 11 Korrik 2008. Adresa e zyrës së regjistruar të Shoqërisë është Rruga “Brigada e VIII”, P.5.

Më 26 Shtator 2008 Fondi Besa (“Fondi”) një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar si një fondacion shtetëror në Shqipëri më 1 Tetor 1998, dhe Shoqëria ranë dakord për transferimin e aktivitetit ekonomik nga Fondi tek Shoqëria sapo kjo e fundit të marrte licencën për veprimtarinë si një institucion financiar jo-bankar.

Shoqëria mori licencën për të operuar si një institucion financiar jo-bankar nga Banka e Shqipërisë më 26 Dhjetor 2008. Në të njëjtën datë, Bordi i Drejtorëve të Fondit vendosi që të mbyllë Fondin dhe aktivet neto ti transferoheshin Shoqërisë dhe pasuritë e tjera të mbetura dhe fitimet e mbajtura t’i transferoheshin Albanian Besa Capital Foundation (“Fondacionit” ose “ABC”) një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar më 25 Korrik 2008 dhe e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 19 Shtator 2008. Themeluesit e Fondacionit ishin punonjësit ekzistues të Fondit, Bajram Mucaj, Irma Disha, Altin Muca, Valbona Xhafa dhe Vangjel Shakaj. Qëllimi i Fondacionit është stimulimi dhe përmirësimi i aktiviteteve ekonomike për bizneset e vogla dhe të mesme; zhvillimi, promovimi dhe zgjerimi i aktiviteteve të tyre; stimulimi i aktiviteteve të tyre financiare në zona të ndryshme të vendit; mbështetja e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit për përmirësimin e aktiviteteve të biznesit në Shqipëri.

Fondi Besa i transferoi aktivet neto duke përfshirë investimet në Shoqëri, aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe pasuritë e investuara në formën e një kredie tek Shoqëria më 1 Janar 2009, në bazë të Marrëveshjes së Transferimit Ekonomik datë 26 Shtator 2008 dhe Marrëveshjes së Rishikuar datë 26 Shkurt 2009. Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe pasuritë e investuara të Fondit Besa iu shitën Shoqërisë në bazë të së njëjtës Marrëveshjeje. Çmimi i transferimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe pasurisë së investuar që u shitën iu shtuan shumës së kredisë.

Fondi Besa dorëzoi totalin e huasë me Shoqërinë tek ABC në bazë të marrëveshjes për dhurimin e fitimeve të mbartura më datë 5 Janar 2009 dhe shtesat në të njëjtën marrëveshje më date 7 Maj 2009.

Më 30 Dhjetor 2008 Fondi Besa i dhuroi Fondacionit ABC 100% të aksioneve të Shoqërisë. Ndryshimi i aksionerëve u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 5 Janar 2009.

Fondi Besa u mbyll më 3 Korrik 2009 dhe u çregjistrua nga Regjistri i Organizatave Jo-Fitimprurëse më 21 Korrik 2009 në bazë të Raportit të Likuidimit më 3 Korrik 2009.

Më 31 Dhjetor 2011, kapitali i paguar i Shoqërisë ishte 833,092,000 Lek (2010: 605,261,000 Lek) i ndarë në 5,000,000 aksione (2010: 5,000,000 aksione) me vlerë nominale 166.62 Lek secili (2010: 121.05 Lek secili) dhe me strukturë pronësie si më poshtë:

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përvec kur nuk është shprehur ndryshe)

1 Njësia raportuese (vazhdim)

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Albanian Besa Capital	80.72%	80.62%
Altin Mucaj	0.62%	0.62%
Vladimir Hysi	0.10%	0.10%
Katerina Zhupa	0.10%	0.10%
Lulzime Semini	0.10%	0.10%
Valbona Xhafa	0.10%	0.10%
Gramoz Bundo	0.10%	0.10%
Irma Mitrusi	0.62%	0.62%
Esat Kamberi	0.06%	0.06%
Dhurata Gjipali	0.10%	0.10%
Edlira Qoli	0.62%	0.62%
Gjystina Kacori	0.10%	0.10%
Gentiana Muco	0.20%	0.20%
Vlerina Xhaxho	0.10%	0.10%
Qetsor Bejko	0.10%	0.10%
Besnik Bani	0.10%	0.10%
Ymer Guga	0.10%	0.10%
Rozana Orozi	0.10%	0.10%
Vangjel Shakaj	0.20%	0.20%
Reshit Hida	0.10%	0.10%
Shpresa Dingo	0.10%	0.10%
Blerta Dervishi	0.10%	0.10%
Nevruz Callo	0.06%	0.06%
Gezim Skuka	0.10%	0.10%
Perparim Merjemaj	0.20%	0.20%
Albana Imami	0.10%	0.10%
Robert Lukaj	0.20%	0.20%
Kushtrim Cenodemaj	0.10%	0.10%
Suela Pellumbi	0.10%	0.10%
Rezarta Dracini	0.10%	0.10%
Roland Mejdani	0.10%	0.10%
Blendi Duhanxhiu	0.10%	0.10%
Eduart Blloshmi	0.10%	0.10%
Rezart Palla	0.10%	0.10%
Alban Kokalari	0.62%	0.62%
Sotiraq Suli	0.10%	0.10%
Mimoza Korita	0.10%	0.10%
Elidon Tafa	0.10%	0.10%
Henri Kuci	0.20%	0.20%
Shaban Kaziu	0.10%	0.10%
Aida Stojko	0.10%	0.10%
Majlinda Dini	0.06%	0.06%
Gerando Makri	0.10%	0.10%
Gjergji Bimbli	0.10%	0.10%
Sotiraq Koti	0.10%	0.10%
Mark Ndoci	0.10%	0.10%
Hamit Laci	-	0.10%
Kujtim Bumci	0.20%	0.20%

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përvec kur nuk është shprehur ndryshe)

1 Njësia raportuese (vazhdim)

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
Arben Graca	0.10%	0.10%
Ilir Nathanaili	0.10%	0.10%
Enver Guri	0.10%	0.10%
Bajram Muca	10.00%	10.00%
Kastriot Gjokutaj	0.20%	0.20%
Osjol Gjergo	0.20%	0.20%
Arben Tilko	0.06%	0.06%
Arshin Ajazi	0.10%	0.10%
Murat Ismaili	0.20%	0.20%
Mehmet Basha	0.10%	0.10%
Diana Renja	0.20%	0.20%
Xhevahir Pelivani	0.10%	0.10%
Alqi Vasili	0.10%	0.10%
Fisnik Borici	0.20%	0.20%
Adriatik Mucaj	0.06%	0.06%
Adem Jahollari	0.10%	0.10%
Aferdita Koko	0.10%	0.10%
Sofika Hasa	0.10%	0.10%
Totali	100%	100%

Zyra qendrore e Shoqërisë është vendosur në Tiranë. Më 31 Dhjetor 2011, Shoqëria kishte një rrjet prej shtatëmbëdhjetë degësh rajonale dhe tridhjetëdy agjenci (2010: gjashtëmbëdhjetë degë rajonale dhe tridhjetë agjenci) të vendosura në Shqipëri. Më 31 Dhjetor 2011 Shoqëria kishte 258 punonjës (2010: 203 punonjës).

2 Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(d) Përdorimi i vlerësimit dhe gjykimit

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme, nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël të njohura në pasqyrat financiare paraqitet në shënimin 5.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përveç kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit kthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, të cilat maten me kosto historike, kthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit që lindin nga këmbimi njihen në fitim ose humbje.

(b) Aktivitetet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, dhe huatë në datën e krijimit. Të gjithë aktivitetet dhe detyrimet e tjera financiare fillimisht njihen në datën kur Shoqëria bëhet palë kontraktuale e një instrumenti.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes së tij ose emetimit.

(ii) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose nëse ajo i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktiviteti financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivitetin. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

(iii) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktiviteti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktiviteti ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(iv) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivitetet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivitetet financiare zhvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përvec kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Evidenca objektive që aktivet financiare të zhvlerësohen mund të përfshijë mospagimin nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Shoqëria me terma që Shoqëria nuk do t'i kishte konsideruar në një rast tjetër, të dhëna që një huamarrës do të falimentojë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ndaj Shoqërisë, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin e pagesave ndaj Shoqërisë.

Në cdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim humbjes, janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive tregon se ka ndodhur një ngjarje zhvlerësimi pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Shoqëria vlerëson evidencat për zhvlerësim për huatë dhe paradhëniet në nivel specifik dhe kolektiv. Huatë dhe paradhëniet për të cilat ekziston evidencë objektive për mospagim, ristrukturim, përkeqësim të kushteve ekonomike ose vonesa për më shumë se 30 ditë, vlerësohen individualisht për zhvlerësim specifik. Të gjitha huatë dhe paradhëniet të vlerësuara individualisht të cilat nuk duhet të zhvlerësohen në mënyrë specifike vlerësohen në grup për zhvlerësime të cilat kanë lindur por që nuk janë identifikuar akoma. Huatë dhe paradhëniet në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar të gjithë huamarrësit me karakteristika të njëjta risku.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Shoqëria përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen përkundrajt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen përmes shkarkimit të skontos. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(c) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha, monedha dhe aktive financiare me likuiditet të lartë dhe me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat janë të varura nga risqe të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Shoqëria për administrimin e angazhimeve afat shkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(d) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Shoqëria nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë ose në periudhë afatshkurtër.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte të transaksionit, dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përvec kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë (shiko politikat kontabël (g)).

Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me blerjen e aktivitet.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje me metodën lineare mbi jetën e përdorimit të secilit zë të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Jeta e përdorimit e llogaritur për periudhën aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

- | | |
|----------------------------|--------|
| • Mobilje | 5 vjet |
| • Makina | 5 vjet |
| • Paisje | 5 vjet |
| • Kompjuterat dhe programe | 4 vjet |

Metoda e amortizimit, jeta e përdorimit dhe vlera e mbetur rivlerësohen në datën e raportimit.

(f) Investime në aktive të qëndrueshme

Investimet në aktive të qëndrueshme përfshijnë aktivitet e përvetësuara nëpërmjet proceseve gjyqësore dhe njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi (shikoni politikën kontabël (g)).

Fitimet ose humbjet që lindin nga shitja e këtyre aktiveve njihet si e ardhur ose shpenzim në fitim ose humbje.

SNK 40 "Investime në aktive të qëndrueshme" trajton kontabilizimin dhe paraqitjen e investimeve në aktive të qëndrueshme. SNK 40 paraqet një zgjedhje midis vlerës së drejtë dhe modelit të koston. Shoqëria zgjodhi që investimet në aktive të qëndrueshme t'i trajtojë me kosto.

Amortizimi i investimeve në aktive të qëndrueshme njihet në fitim ose humbje me metodën lineare mbi jetën e vlerësuar të përdorimit të secilit zë të investimeve në aktive të qëndrueshme. Jeta e përdorimit për investimet në aktive të qëndrueshme është 20 vjet. Toka nuk amortizohet.

(g) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Humbjet nga rënia në vlerë njihen nëse vlera kontabël e një aktivi ose një njësie gjeneruese të aktiveve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së përdorimit dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivitet.

Humbjet nga zhvlerësimi të periudhave të mëparshme rishikohen në cdo datë raportimi për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera e mbetur e aktivitet nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përvec kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(h) Huatë dhe detyrimet e tjera financiare

Huatë janë burimi kryesor i financimit të aktivitetit të Shoqërisë.

Huatë dhe detyrimet e tjera financiare fillimisht njihen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që i atribuohen direkt, dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(i) Grantet

Një grant njihet fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ka garanci të arsyeshme se ai do të merret dhe që Shoqëria do të përmbushë të gjithë kushtet e bashkangjitura me të. Grantet njihen si e ardhur në fitim ose humbje sistematikisht në të njëjtën periudhë në të cilën shpenzimet kanë lindur.

(j) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimi i interesit njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton në mënyrë të saktë pagesat dhe arkëtimet e flukseve të ardhshme monetare nëpërmjet jetës së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Shoqëria vlerëson flukset e ardhshme monetare duke konsideruar të gjithë termat kontraktuale të instrumenteve financiare por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshinë të gjithë tarifat e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, dhe zbritjet ose primet të cilat janë një pjesë kryesore e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të cilat i atribuohen direkt blerjes, emetimit ose heqjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në fitim ose humbje përfshijnë interesin nga aktivitetet dhe detyrimet financiare me koston e amortizimit bazuar në normën e interesit efektiv.

(k) Pagesat për qera operative

Pagesat e bëra nën qeranë operative njihen në fitim ose humbje me metodën lineare mbi termat e qerasë. Iniciativat e qerasë njihen si një pjesë kryesore e totalit të shpenzimit të qerasë mbi termat e qerasë.

(l) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato lindin.

(m) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione. Kontributet e Shoqërisë për planin e pensionit njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përveç kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(n) Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet në fitim ose humbje me përjashtim të atyre rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat e tatimit të aprovuara ose kryesisht të aprovuara në datën e raportimit, dhe çdo korigjim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe shumës të përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit të cilat pritet që të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, në bazë të ligjeve të cilat janë aprovuar ose priten të aprovohen në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë aktiv njihet vetëm në atë masë që është e mundshme që përfitime tatimi të ardhshme do të jenë të disponueshme ndaj aktiveve që sjellin përfitime. Tatimi i shtyrë aktiv rishikohet në cdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në atë masë që nuk është më e mundshme që përfitimi i tatimit do të realizohet.

Tatime shtesë mbi fitimin që lindin nga shpërndarja e dividendëve njihen në të njëjtën kohë në të cilën njihet detyrimi për pagesë lidhur me dividendin.

(o) Standarde të reja dhe interpretime të cilat nuk janë adoptuar akoma

Një numër standardesh të reja, amendime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2011, dhe nuk janë aplikuar herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjëri nga këto nuk do të ketë efekte mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë përveç: SNRF 9 *Instrumentet Financiare* i cili bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Shoqërisë në vitin 2015 dhe mund të ndryshojë klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Shoqëria nuk planifikon të aplikojë herët këtë standard dhe shkalla e impaktit nuk është përcaktuar ende.

4 Administrimi i riskut financiar

Përdorimi i instrumenteve financiarë e ekspozon Shoqërinë ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë.

(a) Risku i kredisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kredisë nga aktivitetet e huadhënies. Risku i kredisë është risku i humbjes financiare për Shoqërinë nëse klienti nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti.

Përqëndrimi i riskut të kredisë që lind nga instrumentet financiare ekziston për palën tjetër kur ato kanë karakteristika të njëjta ekonomike të cilat do të shkaktonin aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të jenë njësoj të influancuara nga ndryshime në kushtet ekonomike ose kushte të tjera. Risku i përqëndrimit ndikohet nga lloji i klientit dhe lidhjet me klientët e tjerë të huamarrës të Shoqërisë.

Shoqëria e menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt duke monitoruar nga afër limitet e kreditit, portofolin e kredive dhe përqëndrimin e ekspozimit. Shoqëria mban kolateral ndaj një grupi huash dhe paradhëniesh të klientëve në formën e hipotekës, siguri të tjera të regjistruara mbi aktivet dhe garanci.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përveç kur nuk është shprehur ndryshe)

4 Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 për huatë është analizuar më poshtë:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
<i>Të zhvlerësuara individualisht</i>		
Standarde (0 - 30 ditë vonesë)	291,059,154	51,047,860
Në ndjekje (31 - 90 ditë vonesë)	20,787,788	653,459
Nënstandarde (91 - 180 ditë vonesë)	43,655,808	4,174,646
E dyshimtë (181 - 365 ditë vonesë)	86,110,909	13,905,941
E humbur (mbi 365 ditë vonesë)	33,245,333	31,353,232
Shuma bruto	474,858,992	101,135,138
Fondi për zhvlerësim	(18,918,568)	(18,352,341)
Vlera kontabël (A)	455,940,424	82,782,797
<i>Të zhvlerësuara në grup</i>		
Shuma bruto	4,193,766,133	4,478,500,872
Fondi për zhvlerësim	(205,787,168)	(181,179,593)
Vlera kontabël (B)	3,987,978,965	4,297,321,279
Të ardhura të shtyra (C)	(113,632,412)	(109,724,743)
Totali vlerës kontabël (A+B+C)	4,330,286,977	4,270,379,333

Shoqëria monitoron përqendrimin e riskut të kredisë sipas sektorëve. Një analizë e riskut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

Sektorët	31 Dhjetor 2011	%	31 Dhjetor 2010	%
Tregti	2,052,931,104	49%	2,136,146,550	50%
Shërbime	1,030,011,250	20%	845,143,602	20%
Të tjera	808,062,030	20%	767,693,809	18%
Zejtari	42,215,644	1%	47,625,246	1%
Ndërtim	232,896,415	6%	264,190,297	6%
Transport	227,495,810	5%	211,016,125	5%
Turizëm	48,962,046	1%	64,587,794	2%
Konsumatore	5,253,685	0%	20,018,698	1%
Industria e ushqimit	16,833,462	1%	43,349,756	1%
Industria e lehtë	33,599,510	1%	33,221,550	1%
Interesi i përllogaritur	170,364,169	3%	146,642,583	3%
Të ardhurat e shtyra	(113,632,412)	(3%)	(109,724,743)	(3%)
Fondi i zhvlerësimit	(224,705,736)	(4%)	(199,531,934)	(5%)
	4,330,286,977	100%	4,270,379,333	100%

Huatë e zhvlerësuara

Huatë e zhvlerësuara janë hua për të cilat Shoqëria përcakton se është e mundshme që ajo nuk do të jetë në gjendje që të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin sipas termave kontraktuale në marrëveshjen e huasë. Shoqëria i klasifikon huatë në grupe si standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura sipas ditëvonesave; ndërkohë ajo teston për zhvlerësim të gjithë huatë të cilat paraqesin evidencë objektive për zhvlerësim, duke llogaritur flukset e ardhshme të skontuara dhe duke i krahasuar ato me vlerën kontabël të kredive përkatëse. Huatë të cilat nuk paraqesin evidencë objektive për zhvlerësim individual vlerësohen në grup për zhvlerësim duke përdorur normat historike të Shoqërisë dhe kohët e rikuperimit për zërat e përpunuar të huave me profil risku të ngjashëm.

Fondi BESA Sh.a.

Shënime shoqëruese të pasqyrave financiare

(shumat në Lek, përveç kur nuk është shprehur ndryshe)

4 Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kredisë (vazhdim)

Fondi për zhvlerësimin e huave

Shoqëria ka një fond për humbje nga zhvlerësimi që paraqet llogaritjen e humbjes në portofolin e kredive. Komponentët kryesorë të këtij fondi janë komponentë specifik të humbjes që lidhen me kreditë e testuara individualisht, dhe fondi zhvlerësimi për kreditë në grup ka një grup aktivesh homogjene në lidhje me humbjen e cila ka lindur por që nuk është identifikuar për kreditë e zhvlerësuara individualisht.

Politika e fshirjes kontabël

Shoqëria fshin një kredi (dhe çdo fond për humbjet nga zhvlerësimi që lidhet me të) kur Komiteti përkatës përcakton që një kredi është e pambledhshme. Ky përcaktim arrihet pasi merret në konsideratë informacioni për gjendjen financiare të huamarrësit i cili nuk mund të paguajë detyrimin e tij, ose kur të ardhurat nga shitja e kolateralit nuk janë të mjaftueshme për të paguar të gjithë ekspozimin. Për balanca më të vogla të kredive të standardizuara, vendimet për fshirje zakonisht bazohen në statusin e ditëvonesave të produkteve specifike.

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet e saj financiare që kërkojnë transferimin e mjete monetare ose aktive të tjera financiare.

